

VENDIM
Nr. 26, datë 1.4.2015

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR ADMINISTRIMIN E
RREZIKUT TË KREDISË NGA BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të neneve 57, 58, 61 dhe 68 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, miratuar me vendimin nr. 62, datë 14.9.2011, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, i ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Kreu IV “Teknikat e zbutjes së rrezikut të kredisë”, si dhe aneksi 1 dhe 2, shfuqizohen.

b) Kreu V “Vlerësimi i aktiveve të tjera dhe përcaktimi i fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve” dhe kreu VI “Raportimi dhe mbikëqyrja”, rinumërohen përkatësisht si kreu IV “Vlerësimi i aktiveve të tjera dhe përcaktimi i fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve” dhe kreu V “Raportimi dhe mbikëqyrja”.

c) Nenet 22 deri 26 rinumërohen përkatësisht si nenet 18 deri 22.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gent Sejko